



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12 Prill 2021

Nr: 07

UDHËZIM

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË DORËZIMIT TË KAMERËS PËR VIDEO
RREGJISTRIM NË MJEDISIN E BRENDSHËM TË QENDRËS SË VOTIMIT

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe 22, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

UDHËZON:

1. Ndjekjen e procedurave për dorëzimin e kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit sipas Lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij udhëzimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 12 Prill 2021

Nr. 07

Për miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit

PROCEDURAT E DORËZIMIT TË KAMERËS PËR VIDEO RREGJISTRIM, NË MJEDISIN E BRENDSHËM TË QENDRËS SË VOTIMIT

1. Çdo kamera të jetë e identifikueshme me numrin përkatës të QV-së si dhe të ketë të bashkëngjitur instruksionet e përdorimit të saj.
2. Shpërndarja e kamerave për video regjistrim do të bëhet nga KQZ-ja në ambientet e vendeve të numërimit të votave (VNV), jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) njofton Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) përkatëse për datën dhe orën e caktuar për dorëzimin e kamerave për video regjistrim.
4. Kamera dorëzohet në datën dhe orën e caktuar në ambientet e VNV-së në prani të personit/ave të autorizuar nga KQZ-ja dhe të paktën kryetarit dhe sekretarit të KZAZ-së.
5. Në ditën e dorëzimit të bazës materiale, KZAZ-ja i dorëzon KQV-së kameran për video regjistrim së bashku me aksesoret përbërës, me procesverbal.
6. Operatori teknik, (personi i ngarkuar me detyrë nga KQZ për funksionimin e kamerës), do të jetë i pranishëm në ambientin e QV-së përkatëse në momentin e mbërritjes së bazës materiale për të parë funksionimin e kamerës.
7. Nëse konstaton probleme në funksionim e kamerës, operatori teknik njofton menjëherë KQZ-në.
8. Pas përfundimit të procesit të votimit në QV, operatori teknik heq nga përdorimi kamerën dhe e asambalon atë me aksesoret përkatës.
9. KQV-ja, kamerën me aksesoret e saj i dorëzon së bashku me materialet e tjera zgjedhore në ambientet e VNV-së dhe mbahet procesverbali i nënshkruar nga KQV-ja dhe KZAZ-ja.
10. KZAZ-ja ia dorëzon kamerat me aksesoret përbërës personit/ave të autorizuar nga KQZ-ja duke nënshkruar procesverbalin e dorëzimit.
11. Kamera dhe aksesoret përbërës dorëzohen në magazinat e KQZ-së.